

**Gjykata Supreme e Kosovës**

**Ap – Kž – 214/2010**

**11 janar 2011**

**Prishtinë**

### **NË EMËR TË POPULLIT**

**Gjykata Supreme e Kosovës**, në kolegjin e përbërë prej Gjyqtarit të EULEX-it Lars Dahlstedt si Kryetar i kolegjit dhe me Gjyqtarin e EULEX-it Charles L. Smith III dhe Gjyqtarin e Gjykatës Supreme Salih Toplica si anëtarë të kolegjit, të ndihmuar nga Zyrtari Ligjor i EULEX-it Sampsa Hakala si procesmbajtës,

në procedurën penale kundër:

**Jahja Llukës,**

; i dënuar nga Gjykata e Qarkut në Prishtinë për vepër penale **Deklaratë materiale e rrejshme** (Pikat 1 dhe 2) në kundërshtim të Rregullores së UNMIK-ut 2004/2, neni 10.5, paragrafët (a) dhe (b) të ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut 2006/53 dhe për vepër penale **Pranim i paligjshëm i kontributit** (Pika 3) në kundërshtim të Rregullores së UNMIK-ut 2004/2, neni 10.8 të ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut 2006/53

**M A** ,

; dhe

**H S** ,

Të dy të akuzuar për vepër penale **Mos lajmërim i transaksioneve** në bashkëkryerje, në kundërshtim të Rregullores së UNMIK-ut 2004/2, neni 10.6, paragrafi (b) të ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut 2006/53 dhe të Nenit 23 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (KPPK).

Duke vendosur mbi ankesat e Prokurorit Special të paraqitura më 27 maj 2010 dhe ankesën e të pandehurit Jahja Lluka të paraqitur përmes Avokatëve të tij mbrojtës Ramë Gashi dhe Arianit Koci më 27 maj 2010 kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë në lëndën me numër P.nr. 504/2007, të datës 12 shkurt 2010.

Pas pranimi të përgjigjeve të paraqitura në emër të të pandehurve M. A. dhe H. S. dhe mendimit dhe propozimit të Prokurorit të Shtetit të Kosovës.

Pas seancës së Kolegjit të mbajtur më 11 janar 2010 me dyer të hapura, në praninë e Prokurorit të Shtetit dhe të pandehurve Jahja Lluka, M. A. dhe H. S. dhe Avokatëve të tyre mbrojtës Arianit Koci, Zait Xhemajli dhe Bajram Tmava.

Më 11 janar 2011, sipas Nenit 392 dhe Nenit 420 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK), publikisht shpall këtë

## **AKTGJYKIM**

**Ankesa e Prokurorit Special kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë në lëndën P.nr. 504/2007, të datës 12 shkurt 2010, PRANOHET PJESËRISHT.**

**Ankesa e paraqitur në emër të të pandehurit Jahja Lluka kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë në lëndën P.nr. 504/2007, të datës 12 shkurt 2010, PRANOHET PJESËRISHT.**



Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë në lëndën P.nr. 504/2007, i datës 12 shkurt 2010 ndryshohet si në vijim:

**Dënimi i Jahja Llukës**

**Për Pikën 1: Deklaratë materiale e rrejtshme sipas Rregullores së UNMIK-ut 2004/2, neni 10.5, të ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut 2006/53 dhe Neneve 38 dhe 39 të KPK-së dënohet me 6 (gjashtë) muaj burgim dhe me gjobë prej 6.000 (gjashtë mijë) Eurove.**

**Për Pikën 2: Deklaratë materiale e rrejtshme sipas Rregullores së UNMIK-ut 2004/2, neni 10.5, të ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut 2006/53 dhe Neneve 38 dhe 39 të KPK-së dënohet me 2 (dy) muaj burgim dhe me gjobë prej 2.000 (dy mijë) Eurove.**


**Për Pikën 3: Pranim i paligjshëm i kontributit sipas Rregullores së UNMIK-ut 2004/2, neni 10.8 të ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut 2006/53 dhe Neneve 38 dhe 39 të KPK-së dënohet me 2 (dy) muaj burgim dhe me gjobë prej 2.000 (dy mijë) Eurove.**

**Për Pikat 1 deri 3, sipas Nenit 396 paragrafit 5 të KPPK-së dhe Nenit 71 të KPK-së, është shqiptuar dhe caktuar dënimi unik me 9 (nëntë) muaj burgim dhe një gjobë prej 10.000 (dhjetë mijë) Eurove.**

**Koha e kaluar në paraburgim nga Jahja Lluka do të llogaritet si pjesë e dënimit me burg sipas Nenit 391 paragrafit 1 nënparagrafit 5 të KPPK-së.**

**Sipas Nenit 43 të KPK-së dënimi është pezulluar. Dënimi nuk do të ekzekutohet nëse i dënuari nuk kryen një tjetër vepër penale në periudhën kohore 11 janar 2011 deri 11 janar 2013.**

**Në aktgjykim janë bërë dy ndryshime teknike:**



Në dispozitiv Pika 2 në pjesën që përshkruan veprën penale fjala “Kasabank” është zëvendësuar me fjalët “Banka Ekonomike” dhe në Pikën 3 në pjesën që përshkruan veprën penale viti “2005” është shtuar pas fjalëve “më ose rreth 19 gusht” dhe para fjalëve “dhe duke vazhduar përmes dhe duke përfshirë...”.

Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë në lëndën P.nr. 504/2007, të datës 12 shkurt 2010 VËRTETOHET në pjesën e mbetur.

## ARSYETIMI

### I HISTORIA PROCEDURALE

Aktakuza PP-KT Nr. 133-7/07 kundër Jahja Llukës, M. A. dhe H. S. ishte paraqitur nga Prokurori Publik Ndërkombëtar më 20 shtator 2007. Aktakuza u konfirmua nga Gjykata e Qarkut në Prishtinë më 8 nëntor 2007.


Më 2 shkurt 2009 Kryetarja e Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it caktoi Gjyqtarët e EULEX-it në këtë procedurë penale.

Shqyrtimi gjyqësor u mbajt gjatë 10 dhjetorit 2009 dhe 9 shkurtit 2010 në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë në praninë e Prokurorit Special, të pandehurve dhe Avokatëve të tyre mbrojtës.

Me aktgjykimin e shpallur më 12 shkurt 2010 Gjykata e Qarkut në Prishtinë shpalli të pandehurin Jahja Lluka FAJTOR për akuzat në vijim:

Pika 1: Deklaratë materiale e rrejshme në kundërshtim të Rregullores së UNMIK-ut 2004/2, neni 10.5, paragrafët (a) dhe (b) të ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut 2006/53.

Pika 2: Deklaratë materiale e rrejshme në kundërshtim të Rregullores së UNMIK-ut 2004/2, neni 10.5, paragrafët (a) dhe (b) të ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut 2006/53.



Pika 3: Pranim i paligjshëm i kontributit, në kundërshtim të Rregullores së UNMIK-ut 2004/2, neni 10.8 të ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut 2006/53

Sipas Nenit 396 paragrafit 5 të KPPK-së dhe Nenit 71 të KPK-së Gjykata e Qarkut në Prishtinë e dënoi Jahja Llukën me një dënim unik prej 10 (dhjetë) muajve dhe me gjobë prej 10.000,00 (dhjetë mijë) Euro.

Me aktgjykimin e njëjtë Gjykata e Qarkut në Prishtinë shpalli M. ... A. ... TË PAFAJSHËM për Pikën 4 për veprë penale Mos lajmërim i transaksioneve në bashkëkryerje me H. ... S. ... në kundërshtim të Rregullores së UNMIK-ut 2004/2, neni 10.6, paragrafi (b) të ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut 2006/53 dhe të Nenit 23 të KPPK-së.

Dhe shpalli H. ... S. ... NOT GUILTY TË PAFAJSHËM për Pikën 4 për veprë penale Mos lajmërim i transaksioneve në bashkëkryerje me M. ... A. ..., në kundërshtim të Rregullores së UNMIK-ut 2004/2, neni 10.6, paragrafi (b) të ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut 2006/53 dhe të Nenit 23 të KPPK-së.

Aktgjykimi iu dorëzua Prokurorit Special më 13 maj 2010 dhe të pandehurit Jahja Lluka personalisht më 16 qershor 2010.

Më 27 maj 2010 aktgjykimi u ankimua nga i pandehuri Jahja Lluka dhe nga Prokurori Special.

Përgjigjet ndaj ankesës së prokurorit janë paraqitur më 9 qershor 2010 në emër të të pandehurit H. ... S. ... dhe më 11 qershor 2010 në emër të të pandehurit M. ... A. ...

Më 2 gusht 2010 the ZPShK-ja parashtrroi një mendim dhe propozim mbi ankesat.




## II ANKESAT DHE PËRGJIGJET

Ankesa në emër të Jahja Lluka atakon aktgjykimin e shkallës së parë mbi arsyet e një vërtetimi të gabuar të gjendjes faktike dhe shkelje të dispozitave të ligjit të aplikueshëm. Sipas ankesës i pandehuri nuk ka bërë deklarime apo lajmërimet të rrejshme të qëllimshme kur ka bërë transaksionet sikurse është autorizuar nga Organizata Jo-Qeveritare (OJQ) Komiteti për Mbrojtjen e Ramush Haradinajt (në gjuhën angleze “Fondi për Mbrojtjen e Ramush Haradinajt”) (Fund) sepse të gjitha deklaratimet ishin përgatitur nga një person tjetër në emër të Fondit. Sa i përket donatorëve të Fondit, ankesa pohon, të gjitha detajet e donatorëve ishin bërë goxha publike përmes media-ve. Në lidhje me pikën 3 të aktgjyimit të ankimuar, mbrojtja argumenton se Jahja Lluka nuk mund të shpallet penalisht përgjegjës për kontributet e bëra Fondit sepse Jahja Lluka personalisht nuk ishte marrës i kontributeve të tilla. Në ankesë, mbrojtja propozon që akuzat kundër të pandehurit duhet të hedhen dhe se i pandehuri duhet të lirohet nga ato.

Prokurori Speciale, në ankesën e tij propozon ngritjen e dënimit për të pandehurin Jahja Lluka. Prokuroria atakon kohëzgjatjen e burgimit të shqiptuar kundër Llukës duke argumentuar se gjykata e shkallës së parë ka neglizhuar të marrë në konsideratë rrethanat rënduese që ekzistojnë përderisa padrejtësisht lehtëson dënimin e Llukës. Po ashtu Prokuroria konstaton se periudha e verifikimit është dashur të përcaktohet për Llukën nga gjykata e shkallës së parë, i cili ishte urdhëruar të mbante një dënim me kushte sikurse parashihet me Nenin 43 paragrafi 2 i KPPK.


Sa u përket të pandehurve M... A... dhe H... S..., Prokurori Special propozon të priset aktgjykimi i ankimuar dhe lënda të kthehet në gjykatën e shkallës së parë për rigjykim ose të modifikohet aktgjykimi duke dënuar A... dhe S... për veprat penale me të cilat akuzohen. Në lidhje me këtë, Prokuroria atakon aktgjykimin e ankimuar bazuar në shkeljet esenciale të dispozitave të KPPK (Neni 403 paragrafi 1 nën paragrafi 12), shkelje të ligjit penal (Neni 404 i KPPK) dhe vërtetim të gabueshëm dhe jo të plotë të gjendjes faktike (Neni 405 paragrafi 1 i KPPK). Prokurori konstaton se



aktgjykimi i ankimuar në pjesën e tij të arsyetimit ka mungesë të arsyetimit të aktgjykimit që ndërlihet me faktet materiale ose atë që arsyet e paraqitura janë të paqarta dhe kundërthënëse. Prokurori vëren se madje edhe sipas konstatimeve të gjykatës së shkallës së parë A. [ ] dhe S. [ ], ishin mjaft të vetëdijshëm për dyshimet në disa transaksione por megjithatë nuk i kanë bërë lajmërimet e nevojshme. Prandaj lirimi nga akuzat bazuar në mungesën e qëllimit nuk mbështetet me faktet e vërtetuara. Si pikë të tij të dytë, Prokurori argumenton se A. [ ] dhe S. [ ], si Drejtor Gjeneral të Kasabank-ës (KSB) dhe Menaxher të shitjes të KSB dhe Menaxher të Degës, Dega e KSB në Prishtinë, kanë pasur obligim të përgjithshëm të lajmërojnë, bazuar në Paragrafin 3.12 të Rregullores së UNMIK-ut 2004/2. Prandaj lirimi nga akuzat i këtyre të pandehurve në shkallën e parë do të përmblihte shkelje të ligjit penal. E treta, prokurori pretendon vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike në aktgjykimin e shkallës së parë sepse sipas mendimit të tij dëshmitë e administruara qartë dëshmuar fajësinë dhe përgjegjësin penale të pandehurve.

Avokatët Mbrojtës të M. [ ], A. [ ] dhe H. [ ] S. [ ] me përgjigjet e tyre në ankesën e Prokurorit Special konstatuan se ankesa është e pabazuar dhe duhet të refuzohet. Mbrojtja e A. [ ] dhe S. [ ] argumenton se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk përmban ndonjë shkelje të dispozitave të procedurës penale. Dispozitivi dhe arsyetimi në mbështetje të saj përmbush të gjitha kushtet ligjore. Për më tepër vërtetimet faktike ishin bërë në mënyrë të drejtë dhe ishin mbështetur nga dëshmitë e paraqitura gjatë shqyrtimit kryesor. Avokatët mbrojtës pohuan se të pandehurit nuk kanë pasur qëllim kriminal në lidhje me mosveprimin për të lajmëruar në Qendrën e Inteligjencës Financiare (QIF) të ndonjë akti të dyshimtë ose transaksioni ose transaksion në monedha prej 10.000 Euro ose më tepër.

Prokurori i Shtetit sipas mendimit dhe propozimit të tij argumenton se ankesa e të pandehurit Jahja Lluka është e pabazuar e në këtë mënyrë e bën Gjykatën Supreme të refuzoj atë përderisa Prokurori i Shtetit propozon të pranohet ankesa e Prokurorit Special dhe e shtytë Gjykatën Supreme të prish aktgjykimin e shkallës së parë dhe dërgoj lëndën mbrapa për rigjykim ose ndryshoj aktgjykimin e ankimuar dhe shqiptoj dënim më të rreptë për të pandehurin Jahja Lluka dhe të dënoj të pandehurit M. [ ] A. [ ] dhe



H... S... për veprat penale me të cilat janë akuzuar. Prokurori i Shtetit përsërit të njëjtat arsye për ankesë sikurse në ankesën e Prokurorit Special.

### III GJETJET E GJYKATËS

#### A. Pranueshmëria e ankesave


Gjykata Supreme konstaton se të dy ankesat e mbrojtjes, të Jahja Llukës dhe Prokurorit Special janë paraqitur në kohë dhe janë të pranueshme.

Aktgjykimi i ankimuar ishte dërguar te Prokurori Special më 13 Maj 2010 dhe personalisht te i pandehuri Jahja Lluka më 16 Qershor 2010. Që të dy ankesat ishin paraqitur në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë më 27 Maj 2010 pra brenda afatit 15 ditor sikurse urdhërohet në Nenin 398 të KPPK. Ankesat ishin paraqitur nga personat e autorizuar për atje.

#### B. Përgjegjësia penale e Jahja Llukës

Akuzat penale kundër Jahja Llukës janë të ndërlidhura me veprimin e Organizatës Jo-Qeveritare (OJQ) e quajtur Komiteti për Mbrojtjen e Ramush Haradinajt (në gjuhën angleze “Fondi për Mbrojtjen e Ramush Haradinajt”) (Fund). Ramush Haradinaj, ish Kryeministër i Kosovës, në atë kohë akuzohej për veprat penale të pretenduara nga Tribunali Penal Ndërkombëtar për ish Jugosllavinë (TPNJ).

Në aktgjykimin e ankimuar ishte vërtetuar se z. Lluka është një nga bashkë-themeluesit e Fondit të Mbrojtjes. Në Maj 2005 Fondit i është dhënë statusi i Organizatës Jo Qeveritare (OJQ). Po thuajse në Mars të atij viti Lluka kishte hapur një llogari bankare në Kasabank në emër të Fondit dhe në Prill 2005 nga Lluka ishte hapur një llogari tjetër bankare në Bankën Ekonomike në emër të Fondit. Më tej është vërtetuar se Lluka ishte i autorizuar të përfaqësoj Fondin d.m.th me qëllim të kryerjes së transaksioneve në emër të Fondit në lidhje me depozitimin e donacioneve në llogaritë e Fondit në Kasabank dhe




Bankën Ekonomike. Gjykata Supreme vëren se autorizimi i këtillë nuk është atakuar me ankesën e Jahja Llukës.

Brenda veprimtarive të Fondit, Lluka ishte i ngarkuar me bërjen e depozitimeve në xhironlogaritë bankare të Fondit dhe është e *padiskutueshme* që Lluka ka bërë depozitime të shumta në xhironlogaritë bankare në emër të Fondit të përmendura më lart (ose donatorëve të Fondit) dhe se shuma totale e parave të depozituara ishte më shumë se 1,5 milion Euro.

Sipas akuzave, Lluka – duke kryer depozitim të monedhave në llogaritë bankare të Fondit në Kasabank dhe Bankën Ekonomike në Prishtinë – vullnetshëm ka shkelur dispozitat e Rregullores së UNMIK-ut 2004/2 mbi përmbajtjen e shpëlarjes së parave dhe veprat penale të ndërlidhura. Gjykata Supreme ri-konfirmon se asnjë akuzë kundër asnjë të pandehuri në këtë çështje nuk përfshin kryerjen e *Shpëlarjes së Parave* si të tillë. Rregullorja e UNMIK-ut në pjesën në lidhje me akuzat ka paraparë një sistem lajmërimi të domosdoshëm me qëllim të parandalimit dhe zbulimit të veprimtarive të Shpëlarjes së parave në Kosovë. Në mënyrë më specifike, rregullorja urdhëron obligim për bankat për të lajmëruar transaksionet e këtilla në Qendrën e Informimit Financiar, duke përfshirë secilën nga të gjitha transaksionet në monedha 10.000 (dhjetë mijë) euro ose më shumë. Transaksionet e shumëfishta trajtohen si transaksion i vetëm nëse banka është në dijeni se transaksionet nga, ose, në emër të një personi janë në total 10.000 Euro në një ditë të vetme. Për më tepër, rregullorja urdhëron obligim për të gjithë personat e përfshirë në transaksione të tilla – duke përfshirë çdo depozitues individual – ti jap bankës informata dhe dokumente që vërtetojnë nëse depozituesi është duke vepruar në emrin e tij ose si agjent i autorizuar për dikën tjetër.


Në aktgjykimin e shkallës së parë është vërtetuar se në mes të 19 Gushtit 2005 dhe 25 Janarit 2007 Lluka në raste të shumta ka bërë depozitim në monedha të më shumë se 10.000 euro gjatë një dite të vetme në llogarinë e Fondit në Kasabank dhe Bankën Ekonomike në Prishtinë duke ndarë dhe strukturuar depozitimet në transaksione të shumëfishta në shuma më pak se 10.000 euro dhe në emër të personave të tjerë të shumtë



duke kompletuar ose shkaktuar përmbushjen e dokumenteve të depozitimit që rrejshëm kanë pasqyruar burimin dhe shumat e përfshira. Në veçanti, akuza ndërlidhet me 8 incidente të ndara ku Lluca ka depozituar në llogarinë në Kasabank shumat me vlerë nga totali 45.000 deri në 363.000 Euro në transaksione të shumëfishta që kurrë nuk kanë tejkaluar 10.000 Euro për një transaksion dhe në tri raste të ndryshme lidhur me Bankën Ekonomike. Banka Ekonomike. Sipas faturave të depozitimit, depozitimet ishin bërë në emër të individëve të tjerë më tepër se të vetë Llukës përderisa në shumë raste Lluca vet kishte nënshkruar faturat e depozitimit.

Si arsye e parë për ankesë, mbrojtja e Jahja Llukës pohon se të gjitha të dhënat dhe raportet e bëra gjatë transaksioneve ishin korrekt. Gjykata Supreme konstaton këtë arsyetim të ankesës të jetë zhurmëmadh në kundërshtim me deklaratimet e vet Llukës më 17 Prill 2009 para Prokurorit Publik sikurse u reflektua në aktgjykimin e ankimuar (faqja 11 e versionit në gjuhën angleze). Sipas pranimeve të vet Llukës ai e ka ndarë një donacion në monedha të më shumë se 500.000 (pesë qind mijë) Euro në shuma më të vogla kur i ka depozituar paratë dhe i ka bërë depozitimet në emrat e individëve të tjerë si donator të vërtetë. Ky pranim i vetëm e bën bazën e ankesës të pakuptimtë.


E dyta, ankesa e Llukës mohon përgjegjësin penale mbi bazat se ishin persona të tjerë, që punonin për Fond, të cilët kanë përpiluar deklaratimet apo lajmërimet të cilat u ishin paraqitur bankave dhe përmbajtja e të cilave u dëshmuar të ishte e rrejshme. Gjykata Supreme konsideron këtë arsyetim të ankesës të pabazuar pasi që Lluca nuk do të shmangej përgjegjësisë penale edhe nëse lajmërimet apo deklaratimet të cilat përmbajnë informata të rrejshme do të ishin përgatitur nga dikush tjetër e jo nga Lluca personalisht ose në emër të Llukës ose të Fondit. Paraqitja apo shfrytëzimi i dokumenteve të këtilla është i penalizuar veçan sipas Nenit 10.5 të Rregullores së UNMIK-it 2004/2 bashkë me Nenin 3.5 të njëjtë, sikurse po ashtu është specifikuar në dispozitivin e aktgjykimin të ankimuar (pikat 1 dhe 2: "... ose ka shfrytëzuar ose shkaktuar bërjen ose përdorimin e dokumenteve duke ditur që dokumentet përmbajnë thelbësisht deklarime të rrejshme ose hyrje, mosveprime ose gabime..."). Për më tepër, në këtë lëndë të veçantë është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar se Jahja Lluca jo vetëm që ka paraqitur por po ashtu ka bërë



dokumente të rrejshme duke nënshkruar faturat e depozitimit që mbanin një emër të rrejshëm si depozitues.

Në ankesë pretendohet se Jahja Lluka nuk kishte qëllim të mos veprojë apo të zbulojë çfarëdo informate kështu që i mungonte përgjegjësia penale. Gjykata Supreme konstaton se kjo pikë e ankesës është jomeritore. Siç është deklaruar në faqet 9-10 të versionit në gjuhën Angleze të aktgjykimit të ankimuar mund të përfundohet nga deklaratat e dëshmitarëve: M. D., M. M., A. M. dhe G. S. e gjithashtu edhe të deklaratave të dhëna nga vet i pandehuri që Jahja Lluka ka bërë një numër të madh të depozitimeve, secila prej shumave më e vogël se 10.000 Euro, që të gjitha arrijnë shumën deri 100.000 – 363.000 Eurove në ditë. Dokumenti i depozitimit tregonte personat tjerë se sa Lluka si donatorë por në shumicën e rasteve megjithatë e kishin nënshkrimin e Llukës. Gjykata Supreme vëren që ankesa e Llukës bile edhe nuk pretendon që Lluka ka paraqitur ndonjë dokument që e autorizon atë për të kryer transaksionet në emër të personave nën emrat e të cilëve transaksionet ishin kryer. Nga të gjitha rrethanat e lartpërmendura është e qartë për këtë kolegji që Jahja Lluka me dashje i kreu depozitimet me qëllim të mos kalimit të pragut ligjor të 10.000 Eurove për depozitim dhe kështu duke iu shmangur obligimeve që rrjedhin nga Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2004/2, mbi pengimin e shpëlarjes së parave dhe veprave të lidhura penale. Në këtë respekt Gjykata Supreme pajtohet me vlerësimin e provave të bëra nga gjykata e shkallës së parë dhe të përfundimeve të saj.

Lidhur me pikën 3 të akuzave, ankesa e Llukës përfundimisht pretendon që ekziston vërtetimi i gabueshëm i gjendjes faktike pasi që Lluka nuk ka pranuar personalisht ndonjë kontribut ditor që tejkalon shumën e 1.000 (një mijë) Eurove. Gjykata Supreme gjithashtu gjen këtë pikë të ankesës të pabazuar. Siç tashmë është lartpërmendur Lluka ishte përfaqësues i autorizuar i fondit. Bazuar në faktet e vërtetuara Gjykata Supreme përfundon se duke e marr detyrën e depozitimit të këtyre shumave të parave Lluka *de facto* në emër të fondit i ka pranuar këto kontribute. Pasi që shumat e të hollave gjithashtu në masë të madhe e tejkalojnë pragun e 1.000 (një mijë) Eurove, Gjykata Supreme në



përfundim nuk gjen vërtetim të gabueshëm apo jo të plotë të gjendjes faktike në aktgjykimin e ankimuar.

### **C. Dënimi i Jahja Llukës**

Bazuar në të dyja ankesat dhe në pajtim me nenin 415 paragrafin 1 të KPPK-së, Gjykata Supreme sipas detyrës zyrtare tani do të veproj në kontrollimin e dispozitivit të aktgjykimit të ankimuar sa i përket dënimit të të pandehurit Jahja Lluka.

Gjykata e shkallës së parë ka shqiptuar dënimin vijues për Jahja Llukën:

Pika 1: me 6 (gjashtë) muaj burgim dhe me gjobë prej 6.000 (gjashtë mijë) Eurove.


Pika 2: me 2 (dy) muaj burgim dhe me gjobë prej 2.000 (dy mijë) Eurove.

Pika 3: me 2 (dy) muaj burgim dhe me gjobë prej 2.000 (dy mijë) Eurove.

Në pajtim me nenin 396 paragrafit 5 të KPPK-së dhe nenit 71 të KPK-së gjykata e shkallës së parë ka përcaktuar dënimin unik prej 10 (dhjetë) muajve burgim dhe të gjobës prej 10.000 (dhjetë mijë) Eurove së bashku me kohën e kaluar në paraburgim nga i akuzuari e llogaritur si pjesë e dënimit me burgim në pajtim me nenin 391 paragrafit 1 nën paragrafit 5 të KPPK-së. Në pajtim me nenin 43 të KPK-së dënimi ishte dhënë me kusht.

Pasi që është vrojtuar në mënyrë të saktë nga prokuroria, gjykata e shkallës së parë nuk e ka shqiptuar periudhën verifikuese në pajtim me nenin 43 paragrafin 3 të KPK-së. Gjykata Supreme konstaton se kjo është shkelje e ligjit penal siç parashihet në nenin 415 paragrafin 1, nën paragrafin 4 dhe në nenin 404 paragrafin 1 nën paragrafin 5. Prandaj, do të urdhërohet periudha e verifikimit.

Sa i përket dënimit, Gjykata Supreme pohon që periudha e burgimit dhe gjoba e shqiptuar nga gjykata e shkallës së parë për secilën pikë është e duhur duke marr parasysh kushtet përkatëse lidhur me veprën penale – kohëzgjatjen dhe shtrirjen e sjelljes penale dhe të



shumës së konsiderueshme të parave që në total ishte objekt i transaksioneve – dhe për të pandehurin – asnjë aktgjykim i mëparshëm i njohur për gjykatën. Në këtë rast, Gjykata Supreme konsideron që qëllimi i dënimit, sjellja e mëhershme e të pandehurit dhe niveli i përgjegjësisë penale dhe rrethanat tjera nën të cilat vepra penale është kryer e arsyetojnë përdorimin e dënimit me kusht në këtë lëndë.

Megjithatë, Gjykata Supreme konstaton se gjykata e shkallës së parë nuk e ka përcaktuar dënimin unik kundër Llukës në pajtim me nenin 71 të KPK-së ku në paragrafin 2 nën paragrafin 2 përshkruhet që dënimi unik duhet të jetë më i madh se secili dënim i veçantë por që dënimi unik *nuk mund ta arrij shumën e të gjitha dënimeve të përcaktuara*. Kështu që sa i përket kësaj aktgjykimi i shkallës së parë duhet të ndryshohet.

#### **D. M. A. dhe H. S.**

Sa i përket të pandehurve M. A. dhe H. S. akuzat kundër tyre lidhet me veprimet e tyre të pretenduara apo mos veprimeve në cilësinë e personave ekzekutivë në Kasabankë. Në aktgjykimin e ankimuar është vërtetuar që në mes të periudhës 19 gusht 2005 dhe 25 janar 2007 M. A. ishte Drejtor Gjeneral i Kasabankës dhe H. S. Sejdiu ishte Menaxher i Shitjes dhe Menaxher i Degës së Kasabankës në Prishtinë.

Sipas akuzës A. dhe S. si zyrtarë të Kasabankës me paramendim dështuan t'i raportojnë Qendrës Financiare Informativë (QFI) lidhur me transaksionet e lartpërmendura të bëra nga Jahja Lluka. Duke mos vepruar të raportojnë A. and S. gjoja se shkelën Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2004/2.

Ankesa e Prokurorit Special pretendon shkelje esenciale të rregullave procedurës penale duke pretenduar se aktgjykimin i ankimuar në pjesën e tij të arsyetimit është i paqartë, i pamjaftueshëm dhe përmban kundërshtime sa i përket shfajësimit të M. A. dhe H. S. Sipas prokurorisë, gjykata e shkallës së parë gabimisht përfundoi që këta të pandehur nuk kanë pasur qëllim të shmangin raportimin e transaksioneve të dyshimta



tek autoritetet kompetente. Prokurori thekson që provat tregojnë se të pandehurit kanë qenë në dijeni të transaksioneve të lidhura me akuzat kundër Jahja Llukës.


Për më tepër, Prokurori Special pretendon se A. ... dhe S. ... në cilësinë e tyre në Kasabankë kanë pasur “detyrë kryesore” të raportojnë siç parashihet në nenet 3.12 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2004/2.

Fillimisht Gjykata Supreme sjell ndër mend se neni 3.9 i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2004/2 përshkruan se *“Bankat dhe institucionet financiare do të raportojnë Qendrës ... (b) Të gjitha transaksionet e veçanta në shumën prej 10.000 Eurove apo më tepër. ...”* Kështu që obligimi për të raportuar bie mbi *personin juridik*.

Gjykata Supreme konstaton se për të qenë në gjendje të dënoj M. ... A. ... dhe H. ... S. ... për vepër të kryer në operacionet e Kasabankës së pari duhet të vërtetohet që të pandehurit ishin të bazuar në funksionin e tyre apo të autorizimit special të besuar me detyrë të drejtpërdrejtë për të zbatuar nenin në fjalë të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2004/2. Me fjalë të tjera do të duhej së pari të dëshmohej përtej dyshimit të arsyeshëm që A. ... dhe S. ... kanë pasur për detyrë të raportojnë transaksionet për QFI siç është specifikuar në nenin 3.9 të Rregullores.

Gjykata Supreme pajtohet që të dytë, A. ... dhe S. ... në fakt ishin të vetëdijshëm për transaksionet e kryera nga Jahja Lluka. Megjithatë, përgjegjësia penale do të pasoj vetëm nëse dëshmitë tregojnë se A. ... apo S. ... ishin në mënyrë të drejtpërdrejtë të përfshirë në aktivitetet e kundër-shpëlarjes së të hollave të Kasabankës dhe që sipas politikës së brendshme të Kasabankës, do të mund të bie nën përgjegjësinë e drejtpërdrejtë të A. ... dhe S. ... që personalisht të raportojnë transaksionet e dyshimta te QFI-ja.

Të pandehurit në përgjigjet e tyre në ankesat e Prokurorit Special kanë mohuar se janë përgjegjës për mos zbulim të informatave për QFI-në.




Nuk ka dispozitë speciale që mund të gjendet në Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2004/2 sa i përket se cili person në bankë ka pasur detyrë të raportoj. Megjithatë, ajo që është e qartë është se neni 3.12 i rregullores – të cilës i referohet prokuroria në ankesë – nuk ka asnjë rëndësi sa i përket kësaj. Ky nen thjesht siguron që ata persona që dorëzojnë raporte nuk do të zbulojnë asnjë informatë na kjo për personat apo entitetet e paautorizuara.

Disa udhërrëfime mund të gjendet në nenin 3.16 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2004/2, ku është e siguruar që bankat dhe institucionet financiare do të emërojnë *personin kontaktues që do të jetë përgjegjës për bashkëveprim dhe shkëmbim të informatave me QFI-në dhe në pajtueshmëri me obligimet e raportimit dhe të mbajtjes së shënimeve* nën këtë Rregullore.

Ky kolegji i ankesave nuk mund të përfundoj përtej dyshimit të bazuar që M. A. dhe H. S. kanë pasur detyrë të raportojnë të gjeturat e tyre QFI-së lidhur me transaksionet e Llukës. Gjykata Supreme konstaton se bazuar në dëshmitë e paraqitura<sup>1</sup> gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë ka gjetur se politika e Kasabankës ishte për secilin punonjës të raportoj transaksionet e dyshimta tek zyrtari special i emëruar i bankës (zyrtari kundër shpëlarjes së parave), të cilit i është besuar detyra të ndërlidh dhe raportoj QFI-në drejtpërdrejtë pa përfshirjen e të pandehurve A. apo S. Për më tepër gjykata e shkallës së parë nuk ka gjetur prova që do të tregonin se A. dhe S. kanë pasur arsye të konsiderojnë që ka ekzistuar diçka e dyshimtë lidhur me transaksionet e kryera nga Jahja Lluka ose që ata kanë pasur qëllim të fshehin informacion nga QFI-ja.

Një nga parimet themelore të procedurës penale siç parashihet në nenin 3 paragrafin 2 të KPPK-së është që dyshimet lidhur me ekzistimin e fakteve përkatëse për lëndën do të interpretohen në favor të të pandehurit (*in dubio pro reo*). Në procedurën penale barra e provave bie në prokurorinë (neni 10 paragrafi 3 i KPPK-së). Në këtë rast fajësia e M. A. dhe e H. S. nuk mund të vërtetohet përtej dyshimit të arsyeshëm prandaj edhe ata duhet të shpallen të pafajshëm.

<sup>1</sup> Shih posaçërisht deklaratat e dëshmitarëve A. M. dhe G. S. gjatë shqyrtimit gjyqësor në faqet 1 – 5 të procesverbalit të shqyrtimit gjyqësor prej procedurës më 28 janar 2010 dhe faqeve 28 – 32 prej procedurës më 18 janar 2010.



#### **IV. PËRFUNDIM**

Bazuar në të gjitha arsyet e lartpërmendura është vendosur si në dispozitiv.

**Ap.-Kž. nr. 214/2010**

**Më 11 janar 2011.**

E përgatitur në gjuhën angleze, gjuhën e autorizuar.

**Kryetar i kolegjit**

Lars Dahlstedt

**Anëtar i kolegjit**

Charles L. Smith III

**Procesmbajtës**

Sampsa Hakala



**Anëtar i kolegjit**

Salih Toplica